



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Kosmati" Sh.P.K. të datës 14.08.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i semaforëve dhe modernizimi i paisjeve tjera për sigurinë në komunikacion-Zona 1 Qendra- Tophane , Dodona ,Ulpiana", Bregu i Dielli , Ulpiana , Dardania , Lakërishta dhe Zona 2 Kodra e Trimave" me nr. të prokurimit 616-25-6001-5-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Kosmati" Sh.P.K. të datës 14.08.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i semaforëve dhe modernizimi i paisjeve tjera për sigurinë në komunikacion-Zona 1 Qendra- Tophane , Dodona ,Ulpiana", Bregu i Dielli , Ulpiana , Dardania , Lakërishta dhe Zona 2 Kodra e Trimave" me nr. të prokurimit 616-25-6001-5-1-1.
- II. LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III.NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV.Vendimi** hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "KOSMATI" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 14.08.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i semaforëve dhe modernizimi i paisjeve tjera për sigurinë në komunikacion-Zona 1 Qendra- Tophane , Dodona ,Ulpiana", Bregu i Dielli , Ulpiana , Dardania , Lakërishta dhe Zona 2 Kodra e Trimave" me nr. të prokurimit 616-25-6001-5-1-1.

Faqe 1 nga 3

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin merititor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

P.1. – *“Per te qene ne gjendje te ofertojme me prodhuesin tone, ky i fundit ka pergatitur oferte te kostumizuar me produkte te dedikuara vetem per kete projekt ne menyre qe te permbushim specifikimet teknike te Dosjes se Tenderit. Perkunder kesaj jane disa produkte per te cilat eshte e kerkuar: Pozicioni 13/ Seksioni C Semaforet ne paramase, kerkohet:- Temperatura e ambientit -40 - 70°C ; Ju lutemi per nje interpretim teknik perse kerkohet specifikisht temperature ne kete brez ? Ketu dihet kontrollerit prodhohen sipas standardeve EN te cilat i percaktojne qarte keto breze te temperaturave. Perse nuk lejohet qe brezi i temperatures te jete me i ulet kur dihet se temperature maksimale ne Prishtine e regjistruar ndonjehere ka qene 39.2 °C (6 Korrik 1988)”.*

P.2. – *“Për më tepër, me datë 14.08.2025, pra sot, Autoriteti Kontraktues ka publikuar sqarime qe korrespondojne me ndryshime teknike ne specifikim, përfshirë të dhëna teknike që ndikojnë drejtpërdrejt në strukturën dhe përmbajtjen e ofertës. Duke qenë se këto ndryshime janë bërë në një fazë shume afer dataes se hapjes se ofertave, është e nevojshme një shtesë kohe për përshtatjen e ofertave teknike dhe financiare. Bazuar në të lartëcekuren, kërkojmë shtyrjen e afatit të dorëzimit të ofertave për një periudhë të arsyeshme, në mënyrë që të mundësohet përgatitja e ofertave të plota dhe të harmonizuara me dokumentacionin e përditësuar të tenderit”.*

Përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast njësia kërkuuese ka bërë shqyrtimin fillestar të pretendimeve ankimore si dhe ka ofruar konstatimet si në vijim:

Lidhur me P.1. njësia kërkuuese ka konstatuar si në vijim *“Të gjitha specifikat teknike janë hartuar në përputhje me standardin EN 12368:2015 – Traffic control equipment – Signal heads. Sipas nenit për kushtet mjedisore, pajisja duhet të përmbushë kërkesat për të tre klasat e temperaturës A, B dhe C, duke mbuluar një domen funksionimi nga -40 °C deri në +70 °C.” Edhe pse temperatura maksimale e ajrit në Kosovë arrin zakonisht deri në rreth +40 °C (të matur në hije), EN 12368 parashikon testim në temperatura më të larta për shkak të ngrohjes shtesë që ndodh nga ekspozimi i drejtpërdrejtë ndaj rrezatimit diellor. Në këtë rast, temperatura e sipërfaqes së kasës dhe komponentëve të brendshëm mund të kalojë ndjeshëm temperaturën e ambientit, duke arritur deri +70 °C. Sa i përket sqarimeve të publikuara në data të ndryshme, është e vërtetë që janë bërë disa publikime shpjeguese; megjithatë, nuk ka pasur ndryshime thelbësore në specifikime që të ndryshojnë strukturën e kërkesave teknike. Ne i kemi pranuar dhe i jemi përgjigjur të gjitha brenda afateve kohore të përcaktuara”.*

Lidhur me P.2. njësia kërkuese ka konstatuar si në vijim "Për më tepër, në funksion të rritjes së konkurrencës dhe inkurajimit të pjesëmarrjes më të gjerë të operatorëve ekonomikë, ne kemi shqyrtuar me kujdes dhe kemi miratuar disa ndryshime të propozuara nga operatorë të ndryshëm. Këto ndryshime janë bërë gjithmonë duke ruajtur pajtueshmërinë me standardin EN 12368:2015 dhe duke mos cenuar kërkesat thelbësore teknike të projektit. Ky qasje siguron balancimin mes integritetit teknik dhe hapjes ndaj inovacionit dhe ofertave më të favorshme në treg".

Pretendimet ankimore të parashtruesit janë shqyrtuar dhe me këtë rast duke u bazuar në konstatimet si më sipër nga njësia kërkuese, është gjetur se këto pretendime janë të pabazuara në kuptim të kësaj kërkesë për rishqyrtim.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 18.08.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.